



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
REKTORATI

SHESHI "NËNË TEREZA", REKTORATI I UT-së, TIRANË  
TEL. +4 222 8402, FAX: +4 222 3981

Formulari nr.1

REALIZIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2014

Realizimi i buxhetit i ndarë në artikuj dhe sipas realizimeve të treguesve përkatës në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

(në 000/mijë lekë)

Artikulli	Emërtimi	Kapitulli	Plani Viti 2014	Realizimi Viti 2014	
				Në Vlerë	Në %
230/231	Investime, Projektme	1 (buxheti)	8,879	8,879	100
		4 (buxheti)	4,030	4,030	57.4
		6 (të ardhurat)	222,678	204,288	91.7
600	Pagat e Punonjësve	8 (buxheti)	799,834	799,771	100
		6 (të ardhurat)	860,368	575,091	66.8
601	Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	8 (buxheti)	125,966	125,966	100
		6 (të ardhurat)	52,327	41,717	79.7
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	6 (të ardhurat)	498,311	230,325	46.2
605	Transferta Korrente Jashtë Shteti	6 (të ardhurat)	1,661	1,661	100
606	Bursa për studentët	1 (buxheti)	96,440	94,198	97.7
	Të tjera transferta tek individët	8 (buxheti)	764	764	100
		6 (të ardhurat)	6,300	3,070	48.7
<b>TOTALI</b>			<b>2,677,558</b>	<b>2,089,760</b>	<b>78.0</b>

**Formulari nr.2**

**BUXHETI PËR VITIN 2015 SIPAS BURIMEVE TË FINANCIMIT**

(në 000/mijë lekë)

Institucion kodi	Llogaria Ekonomike	Kapitulli (burimi i financimit)		Gjithsej	Në përqindje (%)	
		08 (nga buxheti)	06 (nga të ardhurat)		08 (nga buxheti)	06 (nga të ardhurat)
Universiteti i Tiranës	<b>600</b> (shpenzime personeli)	803,500	589,835	<b>1,393,335</b>	57.7%	42.3%
	<b>601</b> (sigurime shoqërore)	127,796	40,332	<b>168,128</b>	76.0%	24.0%
	<b>602</b> (shpenzime korente, mallra shërbime)	-	356,284	<b>356,284</b>	0.0%	100.0%
	<b>605</b> (transerta me jashtë, kuotizacione organizata)	-	2,000	<b>2,000</b>	0.0%	100.0%
	<b>606</b> (bursat e studentëve)	78,000	6,030	<b>84,030</b>	92.8%	7.2%
	<b>231</b> (investime)	-	829,225	<b>829,225</b>	0.0%	100.0%
<b>TOTAL</b>		<b>1,009,296</b>	<b>1,823,706</b>	<b>2,833,002</b>	<b>35.6%</b>	<b>64.4%</b>

**Formulari nr.3****Realizimi i të Ardhurave të Kushtëzuara për vitin 2014***(në 000/mijë lekë)*

<b>Nr.</b>	<b>Njësitë shpenzuese (Fakultete, etj.)</b>	<b>Të Ardhura të Trashëguara 2013</b>	<b>Nga Tarifat e Regjistrimit</b>	<b>Nga Tarifat e Shkollimit</b>	<b>Sponsorizime</b>	<b>Të Tjera (AKTI-Libreza e Diploma, Vërtetime, Qera, Analiza etj)</b>	<b>Gjithsej të Ardhura</b>
1	Rektorati	50,130	-	88	20,254	5,864	<b>76,336</b>
2	Shkencat Sociale	51,060	4,668	216,275		1,090	<b>273,093</b>
3	Drejtësia	93,249	8,414	225,648	401	3,478	<b>331,189</b>
4	Shkencat e Natyrës	7,041	3,034	189,007		15,854	<b>214,937</b>
5	Gjuhët e Huaja	18,252	2,652	114,484		4,639	<b>140,027</b>
6	Histori Filologji-a	29,845	2,875	191,144		2,008	<b>225,872</b>
7	Ekonomiku	70,903	4,243	229,210	51	2,500	<b>306,907</b>
8	Fil.Kukës	1,957		15,770		153	<b>17,880</b>
9	Fil.Sarandë	2,824	195	12,756		176	<b>15,951</b>
10	ISE	20,921	360	18,997		31	<b>40,309</b>
11	IFBZ	5,704				12,970	<b>18,674</b>
	<b>Realizuar total 2014</b>	<b>351,885</b>	<b>26,441</b>	<b>1,213,378</b>	<b>20,706</b>	<b>48,765</b>	<b>1,661,174</b>

## Planifikimi i detajuar i të Ardhurave të Kushtëzuara për Vitin 2015

(në 000/mijë lekë)

Nr.	Njësitë shpenzuese (Fakultete, etj.)	Të Ardhura të Trashëguara nga Viti 2014	Realizimi i Pritshëm 2015	Në Total të Ardhura për Përdorim për Vitin 2015
1	Rektorati	24,399	3,000	27,399
2	Shkencat Sociale	156,520	211,518	368,038
3	Drejtësia	162,104	240,000	402,104
4	Shkencat e Natyrës	50,363	185,000	235,363
5	Gjuhët e Huaja	14,332	121,980	136,312
6	Histori Filologji-a	24,644	220,209	244,853
7	Ekonomiku	105,913	217,200	323,113
8	Fil.Kukës	2,141	8,483	10,625
9	Fil.Sarandë	4,850	5,263	10,112
10	ISE	35,286	12,672	47,958
11	IFBZ	5,028	12,800	17,828
	<b>Plani Viti 2015</b>	<b>585,581</b>	<b>1,238,125</b>	<b>1,823,706</b>

Në lidhje me tarifat e shërbimeve Rektorati i Universitetit të Tiranës ofron shërbimin e:

\* konfirmimit të dokumentacionit, tarifa e këtij shërbimi është 400 lekë

\* aplikim për marrjen e diplomës së doktoraturës, tarifa e këtij shërbimi është 2,000 lekë.

## **RAPORTI VJETOR MBI ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2014 PËR UNIVERSITETIN E TIRANËS**

Buxheti i Universitetit të Tiranës për vitin 2014, paraqitet i përmbledhur, sipas burimeve të financimit dhe artikujve përkatës, në tabelën e mëposhtme:

(në 000 lekë)

Artikulli	Emërtimi	Kapitulli	Plani Viti 2014	Realizimi Viti 2014	
				Në Vlerë	Në %
230/231	Investime, Projekttime	1	8,879	8,879	100
		4	4,030	4,030	57.4
		6	222,678	204,288	91.7
600	Pagat e Punonjësve	8	799,834	799,771	100
		6	860,368	575,091	66.8
601	Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	8	125,966	125,966	100
		6	52,327	41,717	79.7
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	6	498,311	230,325	46.2
605	Transferta Korrente Jashtë Shteti	6	1,661	1,661	100
606	Bursa për studentët	1	96,440	94,198	97.7
	Të tjera transferta tek individët	8	764	764	100
		6	6,300	3,069	48.7
<b>TOTALI</b>			<b>2,677,558</b>	<b>2,089,760</b>	<b>78.0</b>

### **Llogaria 600 dhe 601**

#### **(Fondi i pagave dhe Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore të punonjësve)**

Për vitin 2014 grandit i buxhetit nga pjesa e transfertës së pakushtëzuar, për llogarinë 600 (Pagat e punonjësve) dhe 601 (Sigurime shoqërore dhe shëndetësore), ishte **925,800 mijë lekë**, përkatësisht **799,834 mijë lekë** dhe **125,966 lekë**. Gjatë vitit 2014 një pjesë e fondit të pagave dhe sigurimeve, në masën **764 mijë lekë** është transferuar në llogarinë 606, kapitulli 8, për realizimin e transfertave të tjera drejt individëve (shpërblim për dalje në pension, ndihmë në raste fatkeqësie). Realizimi i fondit të pagave për vitin 2014 është karakterizuar nga një mungesë e konsiderueshme e fondeve nga transferta e pakushtëzuar, duke bërë të pamundur përballimin e nevojave për cdo fakultet. Në tabelën

e mëposhtme paraqitet realizimi i këtij fondi për çdo njësi përbërëse të Universitetit të Tiranës:

(në 000 lekë)

<b>Institucioni</b>	<b>Llog</b>	<b>Kap</b>	<b>Plani me ndryshime</b>	<b>Fakt (600+601)</b>	<b>Në %</b>
UT Rektorati	600/601	8	52,606	52,606	100
Fakulteti Histori-Filologji	600/601	8	112,585	112,585	100
Fakulteti i Drejtësisë	600/601	8	75,629	75,629	100
Fakulteti i Ekonomisë	600/601	8	150,034	150,034	100
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	600/601	8	157,545	157,545	100
Fakulteti i Shkencave Natyrore	600/601	8	244,545	244,545	100
Fakulteti i Shkencave Sociale	600/601	8	81,524	81,524	100
UT Filiali i Kukësit	600/601	8	10,361	10,361	100
UT Filiali i Sarandës	600/601	8	15,334	15,334	100
I S E (Instituti I Studimeve Europiane)	600/601	8	1,424	1,424	100
IFBZ	600/601	8	24,213	24,213	100
<b>GJITHSEJ</b>			<b>925,800</b>	<b>925,800</b>	<b>100</b>

Siç shikohet nga tabela e mësipërme, fondi i pagave dhe sigurimeve shoqerore është realizuar në mënyrë të plotë nga të gjitha njësitë e Universitetit të Tiranës.

Të ndodhur në kushtet e pamjaftueshmërisë së fondit të pagave Këshilli i Administrimit, me Vendimin nr.49, datë 08.10.2014, miratoi rialokimin e fondeve të nevojshme për paga për periudhën e mbetur 2.5 mujore të vitit 2014, në vlerën **171 milion e 366 mijë lekë** nga të ardhurat e kushtëzuara (kap.6), duke pakësuar për të njëjtën vlerë fondet e planifikuara nga shpenzimet operative në mbështetje të aktiviteteve të mësimit dhe kërkimit shkencor (llog. 602.6) dhe nga investimet (llog. 231.6).

Në tabelën e mëposhtme evidentohet fondi i pagave i cili, bazuar në këtë vendim është përballuar nga të ardhurat e kushtëzuara (kap.6) e fakulteteve dhe filialeve në varësi të UT-së:

*(në 000 lekë)*


<b>Institucioni</b>	<b>Llog</b>	<b>Kap</b>	<b>Fakt (600+601)</b>
Fakulteti Histori-Filologji	600/601	6	25,000
Fakulteti i Drejtësisë	600/601	6	20,191
Fakulteti i Ekonomisë	600/601	6	37,448
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	600/601	6	25,800
Fakulteti i Shkencave Natyrore	600/601	6	32,855
Fakulteti i Shkencave Sociale	600/601	6	22,645
UT Filiali i Sarandës	600/601	6	7,427
<b>GJITHSEJ</b>			<b>171.366</b>

Duke zbatuar udhëzimet nga Rektorati, në vitin 2014 fakultetet kanë punuar me përkushtim maksimal për realizimin e pagesave të stafit akademik efektiv dhe jo efektiv.

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm paraqiten norma vjetore, ngarkesa dhe mbingarkesa (të shprehura në ooo/orë mësimore) e paguar për vitin 2014, për stafin akademik të brendshëm dhe të jashtëm të Universitetit të Tiranës, pagesë kjo e përballuar tërësisht nga të ardhurat e institucionit (transferta e kushtëzuar).

Nga të ardhurat e institucionit janë realizuar gjithashtu edhe pagesat e punonjësve administrativë me kontratë, duke e çuar përdorimin e të ardhurave të institucionit për përballimin e pagesave në lidhje me pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si dhe mbingarkesën mësimore në shumën **616,808 mijë lekë për vitin 2014**.

## Analizë e Ilogarisë 600.6 për vitin 2014



Emërtimi	000/orë mësimore	në %
Ngarkesa vjetore	450	100
Norma vjetore	228	51
Mbingarkesa	222	49
nga këto :		
pedagogë të brendshëm	139	63
pedagogë të jashtëm	83	37
Mbingarkesa e konvertuar në nr. Pedag.	854	

Emërtimi	000/lekë
Paga bazë (punonjës në organikë)	181,471
Paga bazë (punonjës me kontratë)	37,203
Orë mbi ngarkesë mësimore	304,240
Pedagogë të jashtëm	50,381
Sigurime shoqërore	41,717
Pagesë pjesëmarrje në komision	1,795
<b>Total</b>	<b>618,808</b>

### **Llogaria 602 (Mallra dhe shërbime)**

Shpenzimet korente (**llog. 602**), që përballohen në masën 100% nga të ardhurat e Universitetit të Tiranës (transfera e kushtëzuar) në përgjithësi u realizuan duke siguruar furniturat me mallra dhe shërbime.

Për këtë kategori të shpenzimeve kuotat e vitit 2014 janë përcaktuar duke marrë në konsideratë si strukturën e stafit akademik ,studentëve dhe specifikat kurikulare të çdo fakulteti apo departamenti, ashtu edhe faktin e vitit paraardhës si dhe kërkesat në p/buxhetin e vitit 2014, duke i dhënë prioritet mbështetjes me furniturat e mallrave dhe shërbimeve për procesin e mësimdhënies.

Në përgjigje të kërkesave të departamenteve të ndryshme, lidhur me financimin e aktiviteteve me karakter mësimor – shkencor janë konsideruar të tilla për t'u mbuluar nga llog. 602 (programi 09450) ato aktivitete që kanë patur pjesëmarrje dhe impakt kurikular për studentët, bazuar në projekte të shoqëruara me preventivat përkatës, në mënyrë që të mbulohen nevojat për këto aktivitete (si furnitura kancelerie, shtypshkrime, etj.). Kështu fakultetet kanë bërë paraprakisht miratimin e këtyre aktiviteteve, në mënyrë që shpenzimet të marrin referencë ligjore. Një vëmendje ka patur në këtë zë të shpenzimeve vënia në dispozicion e fondeve për mbështetjen e pedagogëve doktorantë për pjesëmarrjet e tyre në aktivitete shkencore, të përfshira këto në aplikimet e projekteve.



Në të njëjtën mënyrë, në formën e projekteve të miratuara, është marrë në konsideratë edhe kuota 2% të llog.602 për aktivitete ekstrakurikulare të Këshillave studentore.

Gjithashtu kanë patur mbështetjen e nevojshme financiare në këtë buxhet aktivitetet e Marrëdhënieve me Jashtë; Ceremonitë e Honoris Causa, Dita e Ekselencës, Ceremonitë e diplomimit; Aktivitete të Qendrës së Karrierës si ëorkshop-e & trajnime, Panairi i Punës, Shkolla Dimërore dhe Verore, etj; NES-takime të hapura, debate studentore, leksione të hapura; kostot operacionale për Qendrën e Ekselencës për kërkim Multidisiplinor dhe Inovacionit si dhe një kalendar modest i aktiviteteve sportive universitare, ndëruniversitare kombëtare dhe ndërkombëtare të ekipeve sportive të drejtuar nga Departamentit të Edukimit Fizik.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet realizimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime, në krahasim me planin e miratuar me vendim të Këshillit të Administrimit për vitin 2014. Vihen re kursime në këtë llogari nga procesi i prokurimeve, si dhe metodologjia e planifikimit për të siguruar gjithë nevojat e papritura duke vënë fonde në dispozicion për shpenzime për nevoja emergjente për mallra e shërbime.

(në 000 lekë)

<b>Institucioni</b>	<b>Llog</b>	<b>Kap</b>	<b>Plani me ndryshime</b>	<b>Fakt (602)</b>	<b>Në %</b>
UT Rektorati	602	6	82,461	74,298	90.1
Fakulteti Histori-Filologji	602	6	26,856	22,130	82.4
Fakulteti i Drejtësisë	602	6	109,132	26,761	24.5
Fakulteti i Ekonomisë	602	6	73,332	32,621	44.5
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	602	6	15,604	10,982	70.4
Fakulteti i Shkencave Natyrore	602	6	71,438	26,366	36.9
Fakulteti i Shkencave Sociale	602	6	78,032	17,512	22.4
UT Filiali i Kukësit	602	6	6,359	5,309	83.5
UT Filiali i Sarandës	602	6	5,688	4,009	70.5
I S E	602	6	18,459	884	4.8
IFBZ	602	6	10,949	9,451	86.3
<b>GJITHSEJ</b>			<b>498,311</b>	<b>230,325</b>	<b>46.1</b>

### **Llogaria 605**

#### **(Transferta korente jashtë shteti)**

Artikulli 605 (transferime korente të jashtme), për vitin 2014 është realizuar në masën **1.661 mijë** lekë nga transferata e kushtëzuar në rang Universiteti.

Kjo llogari përfshin pagesat për kuota anëtarësimi dhe pjesëmarrje të institucionit tonë në organizime, projekte dhe aktivitete me institucionet e huaja. Për këtë arsye janë dërguar

dhe në Rektorat nga fakultetet detyrime të tilla që vijnë nga angazhimet e departamenteve apo fakultetit me vendet e huaja dhe nevojat respektive për fondedhe janë përballuar këto pagesa.

**Llogaria 606**  
**(Transferime korente të brendshme, bursat e studentëve)**

Për vitin 2014 grandi i akorduar për Bursa për UT-në (duke përfshirë dhe shtesat e fondit të bëra nga muajin Nëntor-Dhjetor 2014 prej **25.440 mijë lekë**) ishte **96,440 mije lekë** dhe i realizuar sipas pasqyrës së mëposhtme:

*(në 000 lekë)*

<b>Institucioni</b>	<b>Llog</b>	<b>Plan</b>	<b>Fakt</b>	<b>Dif.</b>	<b>%</b>
Fakulteti I Histori-Filologji	606	13,333	13330	2	100
Fakulteti I Drejtësisë	606	10,074	10,074	0	100
Fakulteti I Ekonomisë	606	17,330	17,330	0	100
Fakulteti I Gjuhëve të Huaja	606	13,147	13,147	0	100
Fakulteti I Shkencave Natyrore	606	23,118	20,894	2,225	90.4
Fakulteti I Shkencave Sociale	606	11,130	11,115	14	100
Filiali I Kukësit	606	5,014	5,014	0	100
Filiali I Sarandës	606	3,294	3,294	0	100
<b>Gjithsej</b>		<b>96,440</b>	<b>94,198</b>	<b>2,242</b>	<b>97.7</b>

Ky artikull përfshin të gjitha ato shpenzime për të cilat institucioni nuk përfiton mallra ose shërbime. Shpërndarja e buxhetit për vitin 2014 në këtë atikull ka pasqyruar kërkesat e institucionit tonë për bursat e studentëve të cilat janë planifikuar sipas kuotës së miratuar për bursat, numrit të bursave të ndërmjetme dhe numrin e bursave të studentëve të shkëlqyer, studentët më të mirët e maturës, studentët fëmijë të prindërve të rënë në krye të detyrës shtetërore etj, në përputhje me VKM-në përkatëse, por në kushtet e pamjaftueshmërisë është bërë shpërndarja e këtij fondi për periudhën Janar-Tetor 2014.

Në muajin Nëntor është bërë një shtesë fondi nga ana e Ministrisë së Financave, në këtë llogari, duke bërë të mundur, pagesat e bursave deri në fund të vitit.

Nga të ardhurat e institucionit janë përballuar nga kjo llogari pagesa në masën **3,069 mijë lekë**, transferta të tjera ndaj individëve, kryesisht kthime të ndryshme të tarifave të shkollimit.

**Të Ardhurat e Kushtëzuara**

Për vitin 2014, të ardhurat u arkëtuan në nivelin 109 % të kuotave të planifikuara; ky realizim mund të konsiderohet i kënaqshëm, por në këtë analizë duhet parë edhe saktësia në planifikim dhe kontrolli në arkëtimet e tyre. Gjithsesi duhet të mbahet gjithmonë parasysh efekti i shkaktuar nga numri i kategorive përjashtuese që nuk paguajnë tarifën e

shkollimit, që për vitin 2014 ka qenë i konsiderueshëm. Pasqyra e realizimit, planifikimit dhe përdorimit të të ardhurave të kushtëzuara sipas fakulteteve dhe burimit të krijimit, për vitin 2014 mbështetur edhe në të dhënat e vitit paraardhës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

(në 000 lekë)


Nr.	Njësitet shpenzuese (Fakultete, etj.)	Të Ardhura të Trashëg. 2013	Nga Tarifat e Regjist.	Nga Tarifat e Shkoll.	Sponsor	Të Tjera (Libreza e Diploma, Vërtetim, Qera, etj)	Gjithsej të Ardhura
1	Rektorati	50,130		88	20,254	5,864	<b>76,336</b>
2	Shkencat Sociale	51,060	4,668	216,275		1,090	<b>273,093</b>
3	Drejtesia	93,249	8,414	225,648	401	3,478	<b>331,189</b>
4	Shkencat e Natyrës	7,041	3,034	189,007		15,854	<b>214,937</b>
5	Gjuhët e Huaja	18,252	2,652	114,848		4,639	<b>140,027</b>
6	Histori Filologji-a	29,845	2,875	191,144		2,008	<b>225,872</b>
7	Ekonomiku	70,903	4,243	229,210	51	2,500	<b>306,907</b>
8	Fil.Kukës	1,957		15,770		153	<b>17,880</b>
9	Fil.Sarandë	2,824	195	12,756		176	<b>15,951</b>
10	ISE	20,921	360	18,997		31	<b>40,309</b>
11	IFBZ	5,704				12,970	<b>18,674</b>
<b>I.</b>	<b>Realizuar total 2014</b>	<b>351,885</b>	<b>26,441</b>	<b>1,213,378</b>	<b>20,706</b>	<b>48,765</b>	<b>1,661,174</b>
<b>III.</b>	<b>Shpenzuar fakt 2014</b>						1,075,593
	<b>Diferenca (III.-I.)</b>						(585,581)
	<b>në %</b>						<b>22.4%</b>

Për të ardhurat nuk ka kuota të përcaktuara nga MAS, pasi skema e çeljeve në Buxhet është në kompetencë të Universitetit. Nga MAS vjen vetëm transferi i pakushtëzuar, e cila detajohet së bashku me të ardhurat në një buxhet të konsoliduar.

Në fund të vitit 2014 janë kryer me Degën e Thesarit aktrakordimet përkatëse të njësive të varësisë dhe është bërë kërkesa për rritje të autorizuar për pjesën e pashpenzuar të të ardhurave nga ky vit **për 585 milion e 581 mijë lekë** dhe mbi këtë bazë janë bërë detajimet për vitin 2015, duke i përfshirë si në pagesat e kontratave të lidhura për llogari të vitit 2015, ashtu edhe për nevojat e fakulteteve për vitin 2015.

Nga shuma **1 miliard e 661 milion e 174 mijë lekë** e të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2014, janë autorizuar për përdorim **1 miliard e 75 milion e 593 mijë lekë** ose 78.6 % e tyre për realizimin e pagesave në lidhje me pagat e punonjësve me kontratë dhe atyre të përhershëm (për një periudhë mesatarisht 2.5 muaj), mbingarkesat për stafin akademik, blerjen e mallrave dhe shërbimeve, kryerjen e transfertave për oraganizat

ndërkombëtare, transfertat e tjera drejt individëve dhe realizimin e investimeve, duke rezultuar në një diferencën e mësipërme prej 585,581 mijë lekë të ardhura për t'u transferuar për vitin 2015.



### INVESTIMET

Vëmendja kryesore në realizimin e vitit 2014 kanë qenë investimet, **(llog. 230, 231)**. Një informacion mbi realizimin e Investimeve sipas objekteve, fakulteteve dhe burimeve të financimit (kapitulli 06 – të ardhurat e kushtëzuara dhe kapitulli 01 – fonde nga buxheti i shtetit) paraqitet më poshtë:

*(në 000 lekë)*

Nr	Emërtimi i projektit	Kap.	Llog. Ekon.	Fondi gjithësej	Financim deri Dhjetor 2014	Detyrime për Vitin 2015
1	Rikonstruksion i godinës së NPVU –së, Fakulteti i Shkencave Sociale (përfshirë ngurtësim 5% garanci)	06 (të ardhurat)	2310000	188,173	125,379	0
		01 (buxheti)			62,795	
2	Rikonstruksion dhe përshtatje të ambienteve nga bashkimi i dy godinave në përdorim të Fakultetit të Drejtësisë të UT+ shtesa kontratës	06 (të ardhurat)	2310000	26,578	26,578	0
3	Rikonstruksionin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja+shtesë kontrate	06 (të ardhurat)	2310000	47,207	47,207	0

4	Rikonstruksionin e Fakultetit Historisë-Filologjisë+shtesë kontrate	06 (të ardhurat)	2310000	65,994	63,839	2,155
5	Rikonstruksionin e Fakultetit të Shkencave Natyrore + shtesë kontrate	06 (të ardhurat)	2310000	3,690	3,598	92
6	Mbikëqyrje, Kolaudime të punimeve (Fakul.Drejtësisë, Fakul.Gjuhëve të Huaja, Fakul.Histori Filologjisë, Fakul.ShN, QRT)	06 (të ardhurat)	2300000	1,277	1,277	-
7	Blerje paisje elektronike	06 (të ardhurat)	2310000	34,152	34,152	-
8	Blerje prodhim instalim paisje dhe sisteme mobilimi	06 (të ardhurat)	2310000	68,383	0	68,383
9	Blerje paisje laboratorit për UT	06 (të ardhurat)	2310000	2,945	0	2,945
<b>Nr</b>	<b>Emërtimi i projektit</b>	<b>Kap.</b>	<b>Llog. Ekon.</b>	<b>Fondi gjithësej</b>	<b>Financim deri Dhjetor 2014</b>	<b>Detyrime për Vitin 2015</b>
10	Blerja paisje kompjuterike elektronike per UT	06 (të ardhurat)	2310000	15,546	0	15,546
11	Blerje paisje audio per UT	06 (të ardhurat)	2310000	1,091	0	1,091
	<b>TOTALI UT</b>			<b>455,036</b>	<b>364,824</b>	<b>90,212</b>

Gjatë vitit 2014 është bërë një punë e konsiderueshme dhe janë arritur rezultate konkrete në terren. Pas perfundimit të projektit të zbatimit për objektin "Shtesë Ambiente për UT" (KAMPUSI) u arrit të dal leja zhvillimore e ndërtimit dhe këtë vit pritet fillimi pjesor i punimeve. Janë përfunduar punimet për rikonstruksionin dhe sistemet e mobilimit në objektet e FSHN dhe godinen e re te Fakultetit te Shkencave Sociale, në Fakultetin e Drejtësisë, në Fakultetin e Histori Filologjisë Fakultetin e Gjuhëve të Huaja.